REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LEZHË**
**KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

Nr 4570 Prot. Lezhë, më 14 . 04 .2020

**VENDIM**

Nr. 49 datë 10 . 04 .2020

**"PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR 3 (TRE) FAMILJET E EVAKUUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019 "**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, pikës 5, të vendimit nr. 112, datë 11.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për një ndryshim të Vendimit Nr. 111, datë 06/12/2019 "Per miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019", vendimit nr. 125, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit per vitin 2020 dhe të programit Buxhetor afatmesëm 2020-2022", të ndryshuar, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**VENDOSI:**

1- Miratimin e pagesës së plotë të qirasë, për një periudhë 1-vjeçare, sipas vlerës së tregut të lirë, për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2- Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Prill 2020.

3- Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social të ndjekë të gjithë procesin dhe monitorojë pagesën e qirasë për familjet përfituese, si dhe të njoftojë strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë, përpara afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4- Familjet përfituese sipas këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës në

masën e parashikuar nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

5- Efektet financiare sipas këtij vendimi do të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile parashikuar në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2020.

6- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

7- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**ERNEST RAKAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

KESHILLI I BASHKISE LEZHE

LISTA E FAMILJEVE QE PERFITOJNE BONUS QIRAJE, BANESAT E TE CILEVE JANE DEMTUAR SI REZULTAT I TERMETIT TE DATES 26,11,2019.

| NR. Rendor | NR I DOSJES | EMER/ATESI/MBIEMER | DT.LINDJE | SIPERFAQE | BANORE | ADRESA | STRUKTURA E APARTAMENTIT TE QIRASE QE PERFITOHET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 364 | ESMA QERIM TRUSHI | 1/1/1944 | 86 | 1 | LEZHE | 1+1 |
| 2 | 365 | ZEF NIKOLL SIMONI | 13/3/1931 | | 2 | LEZHE | 1+1 |
| 3 | 366 | NDUE FRAN VUKSANI | 3/2/1959 | 120 | 5 | ISHULL-LEZHE | 2+1 |

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË